



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2031/11 prot.

Datë 16.10.2025

V E N D I M
Nr. 1456 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-52914-07-01-2025, me objekt: “Shërbim Gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering), për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës” me fond limit 4,590,850.30 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “4 S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A. me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Silver” SHPK me NIPT K88010301SL dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr 5, Ruga Bajram Curri, Nr.Pasurie 5/247+1N4,Zona Kadastrale 8260, Pallati Palma e Ar, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 5.11.2020, “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.07.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-52914-07-01-2025, me objekt: “Shërbim Gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering), për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës” me fond limit 4,590,850.30 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 14.07.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 18.07.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Silver	3,206,430	lekë	Kualifikuar
4 S	3,443,194.65	lekë	Kualifikuar
Dion-Al	3,578,190	lekë	Kualifikuar

II.4. Në datën 23.07.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 29.07.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5616 dhe me nr. protokolli 2031/2025, datë 29.07.2025, e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Silver” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2031/1, datë 30.07.2025.

II.7. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, në datën 31.07.2025 operatori ekonomik “Silver” SHPK ka paraqitur argumente, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për

Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2031/2 prot., datë 31.07.2025.

II.8.Operatori ekonomik “Silver “SHPK i ka paraqitur argumentat edhe nëpërmjet shërbimit postar, argumenta të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 2031/3 prot., datë 01.08.2025.

II.7.Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 2024/9 prot., datë 07.08.2025, protokolluar me tonën me nr.2031/4 prot., datë 08.08.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin nr.75/2025, datë 06.08.2025 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, si dhe dokumentacionin e operatorit ekonomik fitues “Silver” SHPK. Referuar vendimit të KSHA rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim të shqyrtimit ka vendosur refuzimin e saj.

II.8. Autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe nëpërmjet shërbimit postar Vendimin e KSHA nr. 75/2025, datë 06.08.2025, protokolluar me tonën me nr.2031/5 prot., datë 08.08.2025.

II.9.Me shkresën nr.2979 prot., datë 23.09.2025, me objekt “*Kërkesë për përshpejtim të shqyrtimit...*”, protokolluar me tonën me nr.2031/6 prot., datë 24.09.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, kërkesë për përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.10.Me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 2031/7 prot., datë 25.09.2025 me objekt “*Kërkesë për informacion*” ka kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) informacionin si më poshtë:

“...Gjatë veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, në kuadër të hetimit administrativ të një procedure prokurimi, si dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 115 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit si më poshtë:

- 1. Kontratat e energjisë elektrike së bashku me adresat në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar "Silver SHPK, me NIPT K88010301S, të cilat janë aktive në datën 14.07.2025, sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar Historik bashkëlidhur.*
- 2. Për kontratat e enegjisë elektrike sipas pikës 1 të kësaj shkrese, subjekti tregtar "Silver SHPK, me NIPT K88010301S, a ka paguar energjinë elektrike dhe a ka plotësuar kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi deri në datën 14.07.2025 ?!”.*

II.11. Në kushtet kur Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) nuk ka dhënë informacionin lidhur me kërkesën e sipërpërmendur të Komisionit të Prokurimit Publi, ky i fundit ju drejtua sërish FSHU me shkresën nr.2031/8 prot., datë 14.10.2025 duke i kërkuar të njëjtin informacion.

II.12. Me shkresën nr.5087/1prot, datë 13.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2031/9 prot, datë 15.10.2025, është depozituar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni si më poshtë:

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 2031/7 Prot, datë 25.09.2025, protokolluar me tonën Nr. 5087 Prot, datë 29.09.2025, nëpërmjet së cilës keni kërkuar informacion mbi kontratat e energjisë elektrike në emër të operatorit ekonomik "Silver" Shpk me NIPT K88010301S, ju informojmë si më poshtë:

1. Nga verifikimet në sistemin tonë të faturimit, kontratat e furnizimit me energji elektrike, active, në datë 14.07.2025 të operatorit ekonomik "SILVER" Shpk, me NUIS: K88010301S, janë:

Kontrata e furnizimit me kod XXXXXX, me adresë të regjistruar "Bajram Curri, nr. 247, 1". Për këtë kontratë subjekti tregtar "SILVER" Shpk rezulton I regjistruar si përdorues për periudhën 14 Tetor 2024 deri më 14 Tetor 2029.

Kontrata e furnizimit me kod XXXXXX, me adresë të regjistruar "Bunavi, Vlorë". Për këtë kontratë subjekti tregtar "SILVER" Shpk rezulton të jetë titular, por përdorues i regjistruar për periudhën Dhjetor 2024 - Korrik 2025, rezulton operatori ekonomik "Elton Sina PF" me NUIS M46615202L.

2. Informacioni lidhur me pagesat e faturave të energjisë elektrike për këto kontrata deri më datë 14.07.2025:

O Për kontratën me kod XXXXXX, përdoruesi "SILVER" sh.p.k rezulton se më datë 14.07.2025 ka paguar detyrimet ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal Sh.a. Pagesa e faturës së muajit Qershor 2025 është kryer më datë 09.07.2025, pra brenda afatit prej 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës.

Për kontratën me kod XXXXXX, përdoruesi "Elton Sina PF" rezulton se më 14.07.2025 nuk ka paguar faturën e energjisë elektrike të muajit Qershor, datë 30.06.2025".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, "4 S" SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "Silver" SHPK, me arsyen se: "Operatori ekonomik SILVER nuk plotëson kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe kriterin e vecantë të kualifikimit, lidhur me plotësimin e saktë të shtojcës 10, sipas kërkesave të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke mos dhënë të dhënat e nevojshme dhe konkrete për të gjitha rubrikat sic ky formular parashikon, referuar edhe vendimit Nr 209/2025 datë 07/02/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe Gjithashtu të gjitha

vërtetimet e tjera të paraqitura në mbështetje të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nuk janë koherente referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimes nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe datat e vërtetimeve të paraqitura në mbështetje të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.1.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë

prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, “4 S” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Silver” SHPK, me arsyen se: “ *Operatori SILVER nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, referuar edhe adresave të deklaruara së fundmi në Bashkinë Tiranë, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Vlorë.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “e” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. [...]

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

III.2.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____.

III.2.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Silver” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

-Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku në Pjesa II, Shkaqet e përjashtimit, A Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ka deklaruar:

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

L. NENI 76/1

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetimi i gjendjes gjyqësore te personave**

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetimi i gjendjes gjyqësore per OE**

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetimi i Statusit Aktiv**

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetimi i pageses se kontributeve.**

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Vertetimi i debisë**

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Nuk kemi shfaqur kurre anje mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme **Ekstrakt i Regjistrit te Pronarit Perfitues.**

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni



Si ofertues në i renditur në vend të parë, referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor, pranë KPP me shkresën nr. 2024/9 prot, datë 07.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2031/4 prot, datë 08.08.2025, operatori ekonomik Silver shpk, ndër të tjera ka dorëzuar edhe dokumentin: Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-4242904-TI, datë 23.06.2025, ku citohet: [...] Bazuar në 24 deklaratimet e deklaruesit...z. L.B, vërtetojmë se kërkuuesi Silver SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod) XXXXXX, përdorues i së ciles është Silver SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjië elektrike, vlerë e llogaritur deri me datën 23.06.2025 përfshirë faturën koherente të muajt Maj 2025.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.2.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

III.2.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.10. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik “Silver” SHPK, në funksion të kriterit të përcaktuar në pikën 1/e të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka deklaruar në formularin

përmbledhës të vetdeklarimit sikurse pasqyrohet në pikën III.2.1 të këtij vendimi. Si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar fizikisht pranë autoritetit kontraktor, përcjellë pranë KPP me shkresën nr.2024/9 prot., datë 07.08.2025, protokolluar me tonën me nr.2031/4 prot, datë 08.08.2025, nga operatori ekonomik “Silver” SHPK rezulton, se ky i fundit ka paraqitur *Vërtetim debie nr. OSHEE-2025-4242904-TI, datë 23.06.2025.*

Referuar pretendimeve të ankimuesit, se operatori ekonomik “Silver” SHPK nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e energjisë elektrike për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas QKB, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr.2031/7 prot., datë 25.09.2025 me objekt *“Kërkesë për informacion”* ka kërkuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) informacionin sikurse pasqyrohet në pikën II.10 të këtij vendimi. Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A (FSHU) me shkresën nr.5087/1 prot., datë 13.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2031/9 prot., datë 15.10.2025, ka dërguar informacionin sikurse pasqyrohet në pikën II.12. të këtij vendimi.

III.2.11. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE *“Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”*, përcaktohet shprehimisht që: *“11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.”*

III.2.12. Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE *“Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”*, përcaktohet shprehimisht që: *“13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”*

III.2.13. Duke u kthyer tek ankesa e paraqitur nga ankimuesi, lidhur me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për të gjitha adresat e aktivitetit sipas QKB nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion, lidhur me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, Furnizuesit të

Shërbimit Universal SHA, si institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Furnizuesin e Shërbimit Universal Sh.A., informacionit të dhënë nga ky i fundit me shkresën nr.5087/1 prot., datë 13.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2031/9 prot., datë 15.10.2025 vërtetohet se, subjekti “Silver” SHPK nuk rezulton debitor, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit. Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Silver” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në SPE dhe atë të dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor, sa i përket shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “4 S” Shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “4 S” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Silver” SHPK, me arsyen se: *“Operatori SILVER, nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, referuar edhe adresave të deklaruara së fundmi në Bashkinë Tiranë, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Vlorë dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar që zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë”,* Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçantë të kualifikimit, nuk ka përcaktuar në asnjë moment që operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe dokumentacion për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë, sikurse animuesi pretendon.. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi ndonjë kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetur mbi kritere të pakërkua dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet

e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por çënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “4 S” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Silver” SHPK, me arsyen se: *“Operatori SILVER nuk ka paraqitur dokumentacion në përmbushje të Rubrikës D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, e cila në rastin konkret vërtetohet me procesverbalin e inspektimit nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH).”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “e” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës; Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

III.4.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, D: Deklarata “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, parashikohet se:

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

III.4.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Silver” SHP, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

-Formularin përmbledhës të vetdeklarimit, ku në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, D: Deklarata, “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”, ka deklaruar:


SILVER SHPK
SINCE 2006

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
• Operatori ekonomik Silver shpk garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. • Operatori ekonomik Silver shpk lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. • Operatori ekonomik Silver shpk nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> Vendim Inspektimi nga ISHPSHSH

Si ofertues në i renditur në vend të parë, referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor, pranë KPP me shkresën nr. 2024/9 prot, datë 07.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2031/4 prot, datë 08.08.2025, operatori ekonomik Silver shpk, ndër të tjera ka dorëzuar edhe dokumentin: “Vendim përfundimtar i inspektimit”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHP), sipas të cilit rezulton se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.

Sa i përket pretendimit të paraqitur nga ankimuesi, se *operatori ekonomik Silver”SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion në përmbushje të Rubrikës D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “Silver” SHPK, si operator i renditur i pari, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentin me emërtim “Vendim përfundimtar i inspektimit”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHP), sipas të cilit rezulton se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Sa më sipër, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Silver” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në SPE dhe atë të dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vertetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor, sa i përket zbatimit të dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “4 S” Shpk nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “4 S” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Silver” SHPK, me arsyen se: *“Punonjësit e paraqitur nga operatori ekonomik nuk janë të regjistruar sipas kodeve përkatëse të kërkuara dhe dokumentacionit shoqërues.”*, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçantë të kualifikimit, nuk ka përcaktuar në asnjë moment që operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë regjistruar punonjësit sipas kodeve përkatëse. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi ndonjë kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetur mbi kritere të pakërkua dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 9 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të

plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “4 S” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Silver” SHPK, me arsyen se: *“Automjeti i paraqitur nga operatori SILVER nuk është i shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, pika 2.3.4 e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.6.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), parashikohet se:

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
--	---

III.6.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Silver” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

-Formularin përmbledhës të vetdeklarimit, ku në Pjesën III, “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, B: Deklaratë, ka deklaruar:



SILVER SHPK
SINCE 2006

Deklarata	Përgjigje															
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>															
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 50 Profili i punonjësve Kimiste , Krye Kuzhinierë, Kuzhinierë , N/d Kuzhiere,Punonjese shpendarje, Sanitare,Shofer, etj <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td>1-</td> <td>K</td> <td>KIMISTE</td> </tr> <tr> <td>2-</td> <td>I</td> <td>KUZHINIERE</td> </tr> <tr> <td>3-f</td> <td></td> <td>Nd/ KUZHINIER</td> </tr> <tr> <td>4-l</td> <td>U</td> <td>Pun/Shperndarje</td> </tr> <tr> <td>5-</td> <td></td> <td>Shofer</td> </tr> </table> <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1-Pajisje kuzhine per gatim 2-Frigorifere 3-Pajisje per servirje ushqimi,etj 4-Mjet frigoriferik ne pronesi te SILVER SHPK ,me targe	1-	K	KIMISTE	2-	I	KUZHINIERE	3-f		Nd/ KUZHINIER	4-l	U	Pun/Shperndarje	5-		Shofer
1-	K	KIMISTE														
2-	I	KUZHINIERE														
3-f		Nd/ KUZHINIER														
4-l	U	Pun/Shperndarje														
5-		Shofer														
Emri, Mbiemri	Linard BALANI															
Firma																



Si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Referuar dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor, pranë KPP me shkresën nr. 2024/9 prot, datë 07.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2031/4 prot, datë 08.08.2025, operatori ekonomik Silver shpk, ndër të tjera ka dorëzuar edhe dokumentat për mjetin frigoriferik me targë AB372AG, të deklaruar në formularin e vetdeklarimit e më konkretisht:

- Leje qarkullimi nr.XXXX në emër të Silver SHPK.
- Certifikatë e pronësisë së mjetit, me këto të dhëna: XXXX, targë XXXX, N. Shasie XXXX, në emër të Silver SHPK.
- Akt miratimi Higjeno Sanitar , lëshuar nga Inspektoriaati Shtetëror Shëndetësor, personit juridik “Silver”SHPK për automjetin frigoriferik me targë XXXX.
- Çertifikatë kontrolli teknik për mjetin me targë XXXX, me afat vlefshmërie 20.05.2026.
- Policë sigurimi për mjetet motorike nr. XXXX, datë 08.05.2025, për mjetin me targë XXXX
- Taksë vjetor e mjeteve me datë 20.05.2025 për mjetin me targë XXXX.

III.6.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “4 S” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Silver” SHPK, me arsyen se *automjeti i paraqitur nga operatori SILVER nuk është i shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar : *Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, i cili duhet të shoqërohet me dokumentacionin plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike. Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari...* Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Silver” SHPK, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se është deklaruar mjeti frigoriferik me targa XXXX. Si ofertues i renditur në vend të parë, referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor pranë KPP rezulton se, nga ana e operatorit ekonomik “Silver”SHPK, është dorëzuar për mjetin e deklaruar dokumentacioni sikurse përmendet në pikën III.6.5. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni vlerëson, se ai është i plotë dhe në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4 të dokumentave të tenderit. Sa më sipër, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Silver” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në SPE dhe atë të dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vertetimin e deklarimeve të bëra në formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor, sa i përket mjetit frigoriferik për transportin e produkteve ushqimore.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “4 S” Shpk nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik, “4 S” SHPK, në procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-52914-07-01-2025, me objekt: “Shërbim Gatimi dhe shpërndarje ushqimi (katering), për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës” me fond limit 4,590,850.30 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4 S” SHPK
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Florent Zguro

